



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË
GJ.P. "AUTOBUSKÁ STANICA" A.D. PRISTINA
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

REAGIM

Prishtinë, 02.04.2020

Reagim i Menaxhmentit të NPL Stacioni i Autobusave sh.a. Prishtinë ndaj artikullit të gazetares Arbisa Shefkui, të publikuar në portalin e KALLXO.COM me datën 01.04.2020

Në kohë pandemie, Stacioni i Autobusëve jep tender për ta vlerësuar kënaqësinë e konsumatorëve

E nderura znj. Arbisa Shefkui dhe redaksi e nderuar e KALLXO.COM

Me vëmendje të veçantë e kemi lexuar artikullin tuaj, të publikuar në portalin tuaj, në mbrëmjen e datës 1 prill 2020. Në fakt, mbetëm paksa të hutuar, ngase patëm vështirësi që të identifikonim se cili ishte mesazhi i artikullit të publikuar në portalin ku punoni ju.

Kjo për shkak se, megjithëse titulli sugjeron krejt diçka tjetër, ju në mënyre shumë të saktë e keni përshkruar gjithë procedurën e përzgjedhjes së ofertuesit më të mirë, të përmbyllur në bazë të procedurave të prokurimit publik dhe të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, që është në fuqi.

E nderuara znj. Shefkui, pra titulli i artikullit tuaj nuk korrespondon fare me realitetin, sepse procedurat për iniciimin e këtij aktiviteti kanë filluar në fillim të muajit mars 2020. Edhe pse në Wuhan të Kines asokohe ka qenë gjendje emergjente për COVID-19, në Kosovë, e besoj edhe te ju znj. Shefkui, çdo gjë ka qenë në rregull. Të gjithë kemi punuar pa pengesa, dhe nuk kemi mundur ta parashikonim të ardhmen. Ndoshta ju znj. Shefkui e keni një dhunti të tillë që t'i parashikoni gjërat, por ne si ndërmarrje nuk e kemi këtë aftësi, andaj edhe nuk e dinim se çka do të ndodhte në të ardhmen!

Tutje, nga përshkrimi në artikullin tuaj nuk shihet asgjë kontestuese, dhe nuk vërehet se është bërë asnjë shkelje që mund të ndërlihet me titullin e artikullit?!

Sipas Ligjit mbi ndërmarrjet publike (Ligji nr. 05/L-009), Bordet e ndërmarrjeve publike një herë në vit duhet ta masin kënaqësinë e konsumatorëve, në bazë të procedurave përkatëse dhe nëpërmjet organizatave kredibile të pavarura. Kjo edhe ka qenë arsyeja e iniciimit të kësaj procedure të përzgjedhjes, ngase kështu e kërkon ligji. Besojmë se të gjithë ne duhet t'i përmbahemi dispozitave ligjore në fuqi, apo jo?

Ndoshta për ju ka qenë e pazakontë që një ndërmarrje publike dëshiron ta bëjë matjen e kënaqësisë së konsumatorëve duke u bazuar në ligj? Apo, mos ndoshta nuk keni hasur që ndonjë ndërmarrje tjetër publike të bëjë veprime të tilla në përputhje me ligjin? Ose, ndoshta dikush që ju ka njoftuar për këtë rast në ndërmarrjen tonë është mësuar me shkeljet e vazhdueshme të ligjit që kanë ndodhur në ndërmarrje bë kohën e menaxhmentit dhe bordit të kaluar, kur vlerësimet e tilla janë bërë vetë dhe për t'ia bërë "qejin vetes", andaj edhe ka dashur të bëjë lajmë diçka që tani nuk ekziston në ndërmarrje? Këtë e dini ju më së miri.

Nga ana tjetër, është e logjikshme edhe për njerëz të zakonitë e lëre më për ata që posedojnë një përgatitje profesionale se në rast se nuk ka konsumatorë/klientë në një biznes s'mund të bëhet intervistimi i tyre. Ndoshta keni menduar se ne ulemi në zyrë dhe vetëm i mbushim pyetësorët, për t'ia

plotësuar dëshirat vetvetes? Mbase ndërmarrja ku punojmë ne edhe ka bërë diçka të tillë dikur, por besoj se edhe ju (si redaksi e Kallxo.com) se në ndërmarrjen tonë është bërë një ndryshim i madh që nga fillimi i vitit të kaluar, kur është ndërruar menaxhmenti dhe bordi i ndërmarrjes.

Ndryshe, në përzgjedhjen e kryeshefit ekzekutiv të ndërmarrjes, z. Luan Hoti, vitin e kaluar, prezent ka qenë edhe përfaqësuesi i BIRN-it/KALLXO.COM, së bashku me përfaqësuesit e Ambasadës Britanike në Kosovë, dhe ka qenë vlerësim unanim i të gjithëve se procesi ka qenë shumë transparent dhe i drejtë, madje Bordi i Drejtorëve ka marrë vlerësim të veçantë për punën e bërë për përzgjedhjen e kandidatit më të mirë.

Znj. Shefkiu, besoj se jeni në dijeni se ndërmarrja NPL “Stacioni i Autobusëve” sh.a. Prishtinë, ka bërë ndryshime të mëdha pas ndërrimit të menaxhmentit. Nëse nuk jeni në dijeni, ju propozojmë që ta vizitoni ndërmarrjen tonë sapo të kalojë gjendja emergjente dhe të njoftoheni drejtpërdrejt për të gjitha këto ndryshime pozitive. Po ashtu, besojmë se në këtë mënyrë do të mund t’i shmangit artikujt e pabazuar në fakte që flasin për ndërmarrjen tonë, dhe që po besojmë joqëllimshëm atë e paraqesin keq në opinion.

Përndryshe, meqë kjo znj. Shefkiu nuk është hera e parë që ju merreni me artikuj paragjykses për ndërmarrjen tonë, sepse edhe me herët keni parashtruar një kërkesë jologjike, po e shohim të udhës që t’ua përkujtojmë se gazetaria kualitative nuk bëhet përmes titujve bombastikë të shkruar nga tavolina, e as nga copëza informacionesh të paverifikuara që eventualisht mund t’i keni marrë nga ku-me-ditë-kush.

Artikuj të mirë znj. Shefkiu nuk janë ata që tek publiku bartin vetëm thashetheme, e as tendenca të dikujt. Ne besojmë fuqishëm se edhe lexuesi kosovar ka nevojë të lexojë ndonjë artikull për ndryshime pozitive që ndodhin tek ne. Prandaj, po e përsërisim, jeni e mirëseardhur që të vini dhe që artikullin e radhës për neve të mos e bëni nga zyra juaj por nga ndërmarrja jonë.

Sigurisht që edhe gjërat atëherë do t’i shihni shumë më ndryshe se sa që ua ka transmetuar dikush.

Dhe për fund, ndërmarrja jone nuk ka pranua asnjë pyetje zyrtare ne asnjë email zyrtar te ndërmarrjes si pretendoni Ju ne shkrimin e Juaj.

Me nderime,

Menaxhmenti i NPL Stacioni i Autobusave sh.a. Prishtinë

Zyra për marrëdhënie me publikun

media@sap-rks.com

+383 (0) 49 769 270